

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

15.01.2025
Ora, 12:23

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 1, datë 05.12.2020, “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, i ndryshuar”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- **Ilirjana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ M. Çelmeta, E. Meta, J. Josifi, P. Doçaj.**

Parti Politike: PD (F. Nuri), PS (E. Xhina)

OJQ: KRIIK

Znj. I. Nano: Mirëdita! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, Sekretaria e Përgjithshme dhe zyrtarë të tjerë të Komisionit Qendror të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Zgjedhjeve, përfaqësues të partive politike, përfaqësues të shoqërisë civile dhe media. Në rendin e ditës së mbledhjes së sotme kemi shqyrtimin e një projektvendimi. “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 1, datë 05.12.2020, “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, i ndryshuar. Para se të fillojmë me shqyrtimin e këtij projektvendimi, do të pyesja kolegët, nëse kanë çështje jashtë rendit të ditës për të diskutuar. Në çdo rast, nëse do të ketë, do të shënojmë rradhën dhe do t’i diskutojmë pas shqyrtimit të projektaktit.

Znj. H. Vukaj: Po kemi..., edhe unë, edhe kolegu!

Znj. I. Nano: Po, zonja Vukaj dhe zoti Çakaj! Mirë, fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit. Një përmbledhje të shkurtër të projektvendimit dhe kush e ka diktuar nevojën për këtë ndryshim. Zoti Meta!

Z. E. Meta: Përshëndetje të nderuar! Referuar nenit 20 pika 1, shkronja “a”, të Kodit Zgjedhor, parashikohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektakte me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së. Qëllimi i udhëzimit nr. 01, datë 05.12.2020, të Komisionit Rregullator, “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, i ndryshuar është të përcaktojë rregullat për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e kësaj harte nga organet e pushtetit vendor. Nga përvoja e deritanishme rezulton se ndryshimet e vendndodhjeve të qendrave të votimit përgjatë proceseve zgjedhore janë diktuar jo


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

nga arsye të forcave madhore. Për zgjedhjet e datës 14 maj 2023, KQZ shqyrtoi dhe miratoi vendosjen e 333 QV-ve në ambiente private bazuar në propozimet e kryetarëve të bashkive. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pas afatit 40-ditor, autorizoi ndryshimin e vendndodhjes së 39 QV-ve për arsye madhore. Për zgjedhjet pararendëse për Kuvend të vitit 2021, u miratua ndryshimi i vendndodhjeve për 105 QV në ambiente private kryesisht në Bashkitë Tiranë 67 raste dhe Durrës 32 raste. Në total, 389 QV u vendosën në objekte private. Ndryshimet e vendndodhjeve shpesh ndodhin për shkak të problematikave si mungësa e energjisë elektrike, dëmtime nga tërmeti i vitit 2019, konstatimi me vonesë nga bashkitë të problematikave funksionale të ambienteve. Gjithashtu është konstatuar se bashkitë kanë ndryshuar në mënyrë të paargumentuar vendndodhjet e qendrave të votimit para periudhës 40 ditë para datës së zgjedhjeve. Në vitin 2023 për shkak të mos rakordimit të të dhënave në sistemet e informacionit nga njësitë e organeve të vetëqeverisjes vendore me DPGJC dhe me KQZ, rezultojnë se rreth 270 qendra votimi me adresa që nuk përputhen me gjendjen reale duke krijuar shqetësime jo vetëm tek zgjedhësit por edhe tek administrata e KQZ-së për të referuar vendndodhjen e saktë të tyre. Ndonëse në disa raste ndërhyrjet u kryen për të siguruar akses më të mirë për zgjedhësit, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara, duhet nënvijëzuar se ky aspekt i ndryshimit të vendndodhjeve të qendrave të votimit vazhdon të mbetet një sfidë që kërkon vëmendje të vazhdueshme. Gjithashtu një problematikë e konstatuar në zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë më 4 Gusht 2024, u evidentuan raste të mos identifikimit të përshtatshëm dhe të duhur nga bashkitë për vendndodhjet e qendrave të votimit dhe infrastrukturës së tyre. Këto situata evidentuan nevojën për ndërhyrje në udhëzimin nr. 1/2020, me qëllim vendosjen e kriterëve objektive për kryetarët e organeve të vetëqeverisjes vendore dhe mekanizmin objektiv të ndërhyrjes së KQZ për rastet kur nga organet


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

vetëqeverisjes vendore nuk respektohen kriteret e përcaktuara në nenet 62 dhe 93 të Kodit Zgjedhor. Neni 62 pika 4, përcakton qarte se “Vendndodhja e qendrës së votimit caktohet në të njëjtën adresë me atë të zgjedhjeve të fundit, me përjashtim të rastit kur për arsye objektive apo të parashikuara në nenin 93 të Kodit Zgjedhor, kjo nuk është e mundur”. Referuar kësaj dispozite vendndodhja e qendrave të votimit është një element thelbësor i procesit zgjedhor dhe ndryshimi i saj i pamotivuar mund të çënojë besimin e zgjedhësve në proces. Ndaj vendosja e kriterëve të qarta synon të sigurojë që ndryshimet e vendndodhjes bëhen vetëm kur ka arsye të forta, të justifikuara, duke përjashtuar çdo mundësi për cënim të këtij standardi. Projektvendimi synon që të vendosen kritere për kryetarët e organeve të qeverisjes vendore në mënyrë që bashkitë të mos ndryshojnë vendndodhjen e qendrave të votimit në mënyrë arbitrare apo për motive të paarsyeshme, të cilat mund të krijojnë konfuzion tek zgjedhësit ose t'i penalizojë ata në mënyrë që mund të përshtaten me ndryshimet. Vendosja e kriterëve synon të ndihmojë në shmangien e vendimeve të paarsyetuara dhe të ruajë qëndrueshmërinë e vendndodhjeve të qendrave të votimit. Propozimet për ndryshime në projektvendimin e paraqitur para jush synojnë rritjen e qartësisë ligjore, sigurimin e një procesi të rregullt zgjedhor, përmirësimin e standarteve të aksesueshmërisë dhe transparencës për të gjitha palët. Projektvendimi ju është përcjellë për mendim shoqërisë civile dhe partive politike. Instituti i Studimeve Politike ka përcjellë disa rekomandime të cilat u vlerësuan nga administrata e KQZ-se. ISP sugjeron që të përdoret termi "kryetari i bashkisë" dhe të përfshihet dhe termi "ushtruesi i funksionit të kryetarit të bashkisë", për të mbuluar rastet kur kryetarët janë në gjendje arresti ose dorëhequr. Termi i përdorur në projektakt është në përputhje me përmbajtjen origjinale të tij dhe me termin e përdorur në Kodin Zgjedhor që është akti specifik që rregullon detyrat dhe kompetencat e organeve të vetëqeverisjes vendore në kontekstin e procesit zgjedhor.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Ndaj vlerësojmë se emërtimi duhet të jetë në përputhje me atë të parashikuar në Kodin Zgjedhor për të siguruar koherencë ligjore. Gjithashtu është kërkuar që, në vend të partive politike, të përfshihen të gjitha subjektet elektorale të regjistruara, përfshirë kandidatët e pavarur, për konsultimin e ambienteve të vendndodhjes së qendrave të votimit. Duke qenë se neni 62 dhe 93 e Kodit Zgjedhor kanë përcaktuar rolin e partive politike dhe subjekteve zgjedhore vlerësojmë që nuk është e nevojshme përsëritja e parimeve. ISP kërkon gjithashtu që Kryetari i bashkisë, Komisioneri të ketë kompetencën e plotë për caktimin e qendrave të votimit, duke siguruar dakordësinë e bashkive, për të garantuar që këto vendndodhje të përmbushin kriteret ligjore. Lidhur me këtë kërkesë sqarojmë se bazuar edhe në vendimin 15/2024 të KAS, Komisioneri ka kompetencën për të vendosur ndryshimin e vendndodhjes së qendrave të votimit në përputhje me kërkesat ligjore. Ndaj parë në këtë këndvështrim bashkitë duhet të mbështesin këtë proces, duke ofruar informacion dhe bashkëpunim. Dakordësia e bashkisë është e rëndësishme, por Komisioneri ka autoritetin dhe përgjegjësinë për të siguruar se vendndodhja e qendrave të votimit është e përshtatshme dhe në përputhje me ligjin. Gjithashtu është kërkuar që të bëhet një plotësim i dispozitës për ta bërë më funksionale rolin e KQZ-së në rastet kur administrata e KQZ-së vlerëson se vendndodhja e QV nuk është bërë në përputhje me kriteret ligjore. Ky rekomandim është marrë parasysht duke riformuluar pikat 4 dhe 6 të projektvendimit. Janë detajuar mekanizmat për monitorimin dhe vlerësimin e qendrave të votimit, veprimet në rast të mosplotësimit të kriterëve dhe procesin vendimmarrës të Komisionerit për caktimin e vendndodhjeve alternative që plotësojnë kriteret ligjore. Për sa më sipër, në këtë relacion, ju paraqitet për shqyrtim dhe miratim.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Meta! Fillojmë shqyrtimin në parim të projektvendimit! Kolegë kemi diçka në parim? Përfaqësuesit e partive politike? Edhe unë do ta mbështesja sjelljen e këtij propozimi, për shkak se ai disiplinon tashmë një proces i cili ka hasur në problematika në zgjedhjet e kaluara lidhur me ndryshimet e mundshme të vendndodhjes së qendrave të votimit, qoftë në ambiente publike, apo në ato private dhe ky disiplinim për më tepër vlen edhe për kryetarët e njësive të vetëqeverisjes vendore, pasi problematikat më të mëdha janë hasur pikërisht në rastet e ndryshimit të vendndodhjeve të qendrave të votimit nga ana e tyre sipas afateve të vendosura në Kodin Zgjedhor. Nëse nuk kemi ndonjë diskutim në parim për projektaktin, kalojmë në votimin në parim. Kolegë,

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Atëherë kalojmë në shqyrtimin e përmbajtjes sipas pikave dhe neneve.

Me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator, vendosi:

Në Udhëzimin nr. 01, datë 05.12.2020, të Komisionit Rregullator, “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Në pikën 3, të nenit 8, në fund të fjalisë shtohet togfjalëshi “ose me mjete elektronike” sipas përcaktimeve të Komisionerit”. Pra, zoti Meta, kjo lidhet me...?

Z. E. Meta: Kjo lidhet me mënyrën aktuale të marrjes së administrimit të informacionit nga bashkitë për vendndodhjen e qendrave të votimit.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Znj. I. Nano: Dakord! Faleminderit! Kemi diçka për pikën 1? Nuk ka! Kalojmë në votimin e pikës 1.

Kush është dakord kolegë?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!


Pika 2. Neni 9, ndryshohet si me poshtë vijon: pra kemi ndryshimin e gjithë përmbajtjes së nenit 9. Neni 9 i titulluar “Ndryshimi i vendndodhjes së qendrës së votimit”.

Pika 1. Për periudhën deri në 41 ditë para ditës së zgjedhjeve, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore mund të ndryshojë vendndodhjen e qendrës së votimit në ambiente publike vetëm për arsye objektive. Në vendimin e tij, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore duhet të arsyetojë dhe dokumentojë shkaqet e ndryshimit duke përfshirë një krahasim të qartë të kushteve të vendndodhjes ekzistuese dhe asaj të re për:

- a. Vlerësimin e kushteve të infrastrukturës dhe aksesueshmërisë së zgjedhësve në ambientin ekzistues dhe atë të ri;
- b. Vlerësimin e kushteve të sigurisë së vendndodhjeve përkatëse;
- c. Verifikimin e kapaciteteve të ambienteve për akomodimin e zgjedhësve. Duke qenë se neni 9 i propozuar për të ndryshuar ka gjashtë pika, unë do të propozoja që të votojmë secilën pikë me rradhë. Atëhere për pikën 1, kemi diçka kolegë? zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Së pari, përgëzime drejtorit respektiv, zotit Meta, për këtë iniciativë, pasi duke akomoduar shqetësimet e grumbulluara rast pas rasti, pra sipas proceseve zgjedhore të kryera. Ky sistemim i vjen për shtat, por njëkohësisht i shërben këtyre

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

handikapeve që mund të sjellin edhe më pas pengesa në zhvillimin e sigurtë të procesit. Përpos kësaj referuar nenit 93, pavarësisht se ndryshimi që është propozuar rri në masë, unë e shoh në një mënyrë tjetër konstruktimin e fjalisë, pra ndërtimin më mirë të fjalisë për hir të kuptueshmërisë së atyre që do ta zbatojnë. Unë si propozim, sjell këtë fjali të re. Për pikën 1, gjithmonë: “Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore mund të ndryshojë vendndodhjen e qendrës së votimit, të përcaktuar në ambientet publike vetëm për arsye objektive, sipas kriterëve të vendosura në Kodin Zgjedhor deri në periudhën 41 ditë para ditës së zgjedhjeve”. Paragrafi vijon me ndryshime të vogla, “Në vendimin e tij, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore duhet të arsyetojë dhe të dokumentojë shkaqet objektive të ndryshimit duke përfshirë një krahasim të qartë të kushteve mes vendndodhjes ekzistuese dhe asaj të re për sa i përket.” Viojmë me germa që përmban pika 1 të cilat i gjej të përshtatura më mirë sipas leximit të propozimit të ri që do të sjell.

Germa “a”. Vlerësimi të kushteve të infrastrukturës dhe aksesueshmërisë për zgjedhësit në ambientin ekzistues dhe atë të ri;

Germa “b”. Vlerësimi të kushteve të sigurisë së ambienteve të vendndodhjeve përkatëse (asaj ekzistuese dhe asaj të re);

Germa “c”. Verifikimi të kapaciteteve të ambienteve për akomodimin e zgjedhësve”. Këto ishin propozimet për sa i përket pikës 1 dhe germave respektive.


Znj. I. Nano: Dakord zonja Vukaj! Kemi diçka tjetër për pikën 1 nga partitë politike? Kalojmë në votimin e pikës 1 me riformulimin e propozuar nga zonja Vukaj?

Kush është dakord kolegë?

Pro: 5 (zgj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, zgj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 2. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dërgon në KQZ vendimin shoqëruar me relacionin, i cili duhet të përmbajë të dhëna të qarta për statusin e ambientit ekzistues dhe atij të ri (propozuar), duke përfshirë arsyet që diktojnë këtë ndryshim, të tilla si:

a. Dhënia e sqarimeve nëse vendndodhja e re ndodhet brenda të njëjtit territor kompakt dhe të pashkëputur gjeografik për zonën e QV-së.

b. Nëse vendndodhja e re e QV-së është në një zonë tjetër qendre votimi duhet të specifikojë arsyet për këtë ndryshim dhe nevojën që e dikton këtë ndryshim.

c. Distancën (në metra/ km) të vendndodhjes së re nga vendndodhja e mëparshme dhe nga zona ku banojnë zgjedhësit e QV-së.

ç. Të specifikojë arsyet objektive që çuan në ndryshimin e vendndodhjes dhe të dokumentojë dhe provojë arsyet që e kanë bërë të pamundur përdorimin e vendndodhjes së mëparshme.

Për pikën 2 kolegë, kemi diçka? Po zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Sërish, edhe për pikën 2, po në funksion të nenit 93 të Kodit Zgjedhor, do të bëja rregullimet përkatëse, që t'i rrijë më mirë aplikimit. Duke u nisur nga fjala “statusi”, unë kam një pyetje, çfarë përfaqëson statusi për ju, sepse në kuptimin juridik “statusi” ...

Znj. I. Nano: Në cilën pikë zonja Vukaj?

Znj. H. Vukaj: Në pikën 2, ndër fjalët e fjalisë kemi “.. i cili duhet të përmbajë të dhëna të qarta për statusin e ambientit..”.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Z. E. Meta: Për gjendjen e ambientit.

Znj. H. Vukaj: Për gjendjen e ambientit. Pra, gjendjen infrastrukturore, apo gjendjen e brendshme të ambientit?

Z. E. Meta: Në tërësi, si atë infrastrukturore, si atë teknike...

Znj. H. Vukaj: Dakord! Kështu që meriton të zëvendësohet fjala “statusin” me fjalën “gjendjen” dhe po vijoj të lexoj, si mendoj të ndërtohet më mirë. Pra pika 2, vetëm do të shtohet lidhëza “edhe” pas fjalës “duke përfshirë edhe arsyet që diktojnë këtë ndryshim”. Pika 1, unë mendoj që të shtohet pas rregullimit, “Dhënia e sqarimeve nëse vendndodhja e re...,” në kllapa, mendoj për thjeshtësi, ndoshta administrata e kërkon, por lokalizimi i saj sipas “Google map”. Ju e aplikoni?

Z. E. Meta: Po aktualisht e aplikojmë.

Znj. H. Vukaj: Pra ata e njohin këtë format? Nuk është e nevojshme ta shtojmë? Dakord! Atëherë germën “a” e lemë siç është.

“Germa “b”. Nëse vendndodhja e re e QV-së gjendet në një zonë tjetër qendre votimi atëherë..”, fjala “është” duhet të zëvendësohet me fjalën “gjendet”. “... duhet të specifikojë arsyet objektive...” dhe pjesa tjetër mbetet siç është.

“Germa “c”. Ka vetëm lidhëzat të përshtatura “Distancën (në metra/ km) e vendndodhjes së re nga vendndodhja e mëparshme..” dhe shtohet “e qendrës së votimit si dhe nga zona ku banojnë zgjedhësit e QV-së”. Pra shtohet “e qendrës së votimit si..”. Pjesa tjetër “.. dhe nga zona ku banojnë zgjedhësit e QV-së”, është e njejta siç ka qenë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Germa “ç” në fund të fjalisë shtohet, po e lexoj siç është “Të specifikojë arsyet objektive që çuan në ndryshimin e vendndodhjes dhe të dokumentojë dhe të provojë arsyet që e kanë bërë të pamundur përdorimin e vendndodhjes së mëparshme, të QV-së”.

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj. Në fakt edhe unë kisha një propozim për një ndërhyrje të vogël. Në germën “ç”, “Të specifikojë arsyet objektive që çuan në ndryshimin e vendndodhjes dhe të dokumentojë...”, unë do të propozoja “edhe me foto”. Përveç çdo dokumentacioni tjetër edhe me foto dhe të provojë arsyet. Pra, këto dy propozime nga zonja Vukaj për këto riformulime, nga ana ime kjo. Diçka tjetër ka? Atëherë kalojmë me rradhë në votimin e propozimeve. Propozimet e zonjës Vukaj për zëvendësimin e disa termave dhe shtesa të caktuara në pikën 2.

Kush është dakord kolegë?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kemi dhe një propozim për të shtuar në germën “ç” pas fjalës “të dokumentojë edhe me foto..”.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)


Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kalojmë në,

Pikën 3. Vendndodhja e qendrës së votimit (publik, privat) nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore mund të kërkojë ndryshimin e vendndodhjes së qendrës së votimit me

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

autorizim nga KQZ-ja vetëm për arsye të forcës madhore. Do të konsiderohen forcë madhore fatkeqësitë natyrore që dëmtojnë ose bëjnë të pamundur përdorimin e qendrave të votimit, problemet e papritura infrastrukturore që pengojnë procesin e votimit apo rrezikojnë sigurinë e votuesve dhe administratës zgjedhore në qendrat e votimit. Kërkesa për autorizimin e ndryshimit të vendndodhjes sipas këtij paragrafi shoqërohet me arsyetimin për plotësimin e kriterëve të përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij neni.

Kolegë, kemi diçka për pikën 3? Nuk ka! Zonja Xhina, po!

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS-së: Për teknikë legislative, meqenëse po i hyni teknikës legislative. Vendndodhja e qendrës së votimit (publik, privat) nuk mund të ndryshojë në 40 ditë para datës së zgjedhjeve. 40 ditët e fundit, do të ishte mbivendosje. Për teknikë do të propozoja këtë gjë.

Znj. I. Nano: Kemi ndonjë propozim tjetër kolegë? Atëherë votojmë propozimin e zonjës Xhina! Pra, “Vendndodhja e qendrës së votimit (publik, privat) nuk mund të ndryshojë në 40 ditë para datës së zgjedhjeve”.

Kush është dakord kolegë?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Atëherë, s’kemi gjë tjetër për pikën 3.

Kalojmë në pikën 4. Administrata e KQZ-së monitoron dhe vlerëson qendrat e votimit për të siguruar që ato përmbushin kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Keni diçka për këtë pikë? Jo! Kalojmë në votim!

Kush është dakord?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 5. Në rastet kur administrata e KQZ konstaton se një qendër votimi ose ndryshimi i propozuar nuk përmbush kriteret e përcaktuara në nenet 62 dhe 93 të Kodit Zgjedhor dhe këtij udhëzimi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve njofton kryetarin e njësisë së vetëqeverisjes vendore për gjetjet dhe kërkon zgjidhje alternative brenda afatit të caktuar prej tij në njoftim. Nëse kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore nuk paraqet propozime alternative, administrata e KQZ-së identifikon ambiente alternative (publike ose private), që plotësojnë standardet dhe përgatit një raport të detajuar për t'ja paraqitur Komisionerit. Për pikën 5 kolegë? partitë politike? Nuk ka diçka! Kalojmë në votimin e pikës 5!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 6. Komisioneri shqyrton në seancë publike raportin e administratës së KQZ-së dhe vendos për ndryshimin e vendndodhjes së qendrës së votimit në një ambient alternativ që i plotëson kriteret ligjore. Pas vendimit të KQZ-së, qendra e votimit nuk ndryshon. Për pikën 6, kemi diçka? zoti Çakaj!

Z. M. Çakaj: Faleminderit zonja Kryetare. Unë propozoj të riformulohet pika 6 si më poshtë: “Komisioneri shqyrton në seancë publike raportin e administratës së KQZ-së dhe vendos për ndryshimin e vendndodhjes së qendrës së votimit në një ambient alternativ.” Këtu mbaron fjalia. Pas fjalisë së parë të shtohet fjalia si më poshtë: “Në çdo rast vendndodhja e qendrës së re të votimit, caktohet në përputhje

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

me kriteret e parashikuara në nenin 93, pika 2 të Kodit Zgjedhor”. Mbaron fjalia dhe më pas të vijojë me fjalinë e tretë, “Pas vendimit të KQZ-së, qendra e votimit nuk ndryshon”. E bëj këtë propozim duke qenë se është rasti i caktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit në ambiente private. Në këndvështrimin tim, duhet të respektohen kriteret e parashikuara në nenin 93, pika 2 të Kodit Zgjedhor, veçanërisht kriteri i paanësisë politike të qendrës së votimit.

Znj. I. Nano: Pra, të ruhen të njëjtat kritere si në caktimin dhe në ricaktimin, kur ndryshon vendndodhja?

Z. M. Çakaj: Po!

Znj. I. Nano: Kemi ndonjë propozim tjetër për pikën 6? Kalojmë në votim... po zonja Xhina!

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS-së: Do të ishte ndoshta e udhës që si referim të mos ishte vetëm Kodi Zgjedhor, por dhe te ky akt që jemi duke relatuar? Pra, qendra e re që do të ricaktohet nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve të plotësojë kriteret e parashikuara nga Kodi Zgjedhor, neni 93 dhe në këtë akt që jemi duke shqyrtuar, sepse dhe këtu kemi rregulla specifike.

Z. M. Çakaj: Dakord, por pjesa e parë e këtij akti bën fjalë për caktimin e qendrave të votimit në ambiente publike, ndërsa pjesa e dytë, pra pika 3, 4, 5 bën fjalë..., pra është shtuar dhe koncepti i caktimit të qendrave të votimit në ambiente private. Pra, më shumë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me propozim të kryetarit të njësisë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

së qeverisjes vendore, vendos në rastin e caktimit të vendndodhjes në ambiente private. Në rastin konkret ka të bëjë me..., ndaj konsistonte dhe propozimi.

Znj. I. Nano: Kalojmë në votimin e propozimit të zotit Çakaj, për riformulimin e pikës 6?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Vijojmë, në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

Pika 1 ndryshohet si më poshtë:


“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore apo zyrtari që ushtron këtë funksion, menjëherë pas miratimit të listës së zgjedhësve, dërgon në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, DPGJC dhe Komisionin e Zonës së Administrimit Zgjedhor përkatës, numrin e çdo QV-je, vendndodhjen e tyre, numrin përkatës të zgjedhësve në listën e zgjedhësve, numrin e zgjedhësve me aftësi ndryshe, dhe të dhëna të tjera përfshirë edhe kërkesat e përcaktuara në nenin 6 të këtij udhëzimi me shkresë ose në formë elektronike, sipas udhëzimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Në rastin e ndryshimeve të vendndodhjes së qendrave të votimit deri 41 ditë para ditës së zgjedhjeve dërgon në KQZ, DPGJC dhe në KZAZ, vetëm të dhënat për vendndodhjet që ndryshojnë, jo me vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve. DPGJC duhet të pasqyrojë adresën e përcaktuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore”.

Pika 3 e nenit 10, shfuqizohet. Atëherë, lidhur me këtë pikë, kemi diçka kolegë? Jo! kalojmë në votim!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 5. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!


Miratohet me 5 vota pro!

Atëherë, kalojmë në votimin në tërësi, pasi e kemi miratuar në parim dhe nen për nen, akti ka pësuar disa ndryshime, të cilat do të lutesha të zbardhen në një kohë sa më të shpejtë nga ana e administratës. Kolegë edhe njëherë dokordësinë tuaj lidhur me aktin në tërësi.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Sapo miratuam vendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 1, datë 05.12.2020, “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, i ndryshuar”.

Vendimi nr. 1

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

15.01.2025
Ora, 12:49

JASHTË RENDIT TË DITËS

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-----------|---|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | M. Çelmeta, E. Meta, J. Josifi, P. Doçaj. |
| Parti | Politike: | PD (F. Nuri), PS (E. Xhina) |
| OJQ: | | KRIIK |

Znj. I. Nano: Viojmë me çështjet jashtë rendit të ditës. Kolegia Vukaj dhe më pas kolegu Çakaj. Zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Faleminderit! Jashtë rendit të ditës, pa dyshim që do të zerë vend një çështje e aktualitetit, e cila po i shqetëson mbarë shqiptarët për ecurinë e saj, por njëkohësisht është dhe kërshëria dhe vëmendja e tyre absolute për hir të një procesi i cili shtrohet dhe vihet për herë të parë në zbatim. Bëhet fjalë për procesin e regjistrimit të emigrantëve nga jashtë, ku jo më larg se para dy ditësh, unë kam kërkuar të vijë informacion nga drejtoria respektive mbi gjendjen aktuale. Pra, ecurinë dhe vijueshmërinë e këtij procesi, të dhënat që ju keni akumuluar dhe

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

dispononi në lidhje me situatën, në lidhje me efektivitetin e mbarëvajtjes, në lidhje me raportin aplikim dhe konfirmim, si dhe në lidhje me çështje të tjera të cilat kanë të bëjnë me arsyet e pranimit, refuzimit, apo të tjera problematika që ju keni hasur. Unë kërkova që këtë informacion ta kisha para mbledhjes së ditës së sotme dhe deri më sot, deri më tani, mua ky informacion nuk më është dhënë. Pa dyshim që kjo është shqetësuese që të mos bëhet transparent një proces ndaj të cilit ka vëmendjen e gjithë Shqipëria dhe mbarë diaspora, kjo nuk e di se si mund t'ia vë emrin, por transparente nuk është. Më bën të mendoj që çfarë ka ky proces për të mos u ekspozuar këto të dhëna, ku ne jemi një nga organet që i cili ka ndërtuar platformën e rregullave, mbi bazën të cilave do të ndërvepronte kjo platformë elektronike e regjistrimit, e cila u ndërtua mbi bazën e dy parimeve kryesisht. Të ishte gjithëpërfshirëse dhe të ishte lehtësisht e aplikueshme. Asnjëra dhe as tjetra nuk janë në uniformitet me njëra-tjetrën dhe nuk plotësojnë dot njëra-tjetrën. Të gjithë informacionin që kemi marrë nga media e shkruar vizive, digjitale etj., përkon që gjithëpërfshirja dhe vullneti mund të ekzistojë, por parimi i lehtësisë, nuk ekziston. Pra platforma mbetet një platformë e vështirë. Kjo tregon që parimet që kemi miratuar, nuk qenkan vënë në zbatim, së pari. Së dyti, nuk janë marrë masat, me atë që shohim në mediat dhe numri e tregon, po t'i referohesh platformës. Persona që kanë aplikuar është 16 090 aktualisht dhe pranime janë 2443. A ju duket në kaq kohë, të nderuar, që ka kaluar se këtu ka efektshmëri dhe një vijueshmëri e cila i përgjigjet në kohë të gjithë kërkesave? A mundet që t'i japë zgjidhje KQZ-ja të gjithë kërkesave të aplikantëve kur e dimë që afati është pesë ditor? Unë pres një përgjigje nga administrata, e cila mjaftueshëm e ka cënuar parimin e të treguarit transparent dhe kundër përgjigjuri ndaj kërkesës së një anëtari të Komisionit Rregullator.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj! Zoti Çakaj do të...

Znj. H. Vukaj: Jo, unë dua përgjigje njëherë, sepse vijueshmëria...

Znj. I. Nano: Pra, ndaj them të marrë një përgjigje për këtë çështje që ka ngritur zonja Vukaj, pastaj vijoni ju me çështjen tuaj. Zonja Josifi!

Znj. J. Josifi: Faleminderit! Në fakt ne e kemi marrë kërkesën tuaj për informacion ditën e djeshme, është përcjellë me email dhe përpara mbledhjes së ditës së sotme kemi dërguar materialin me problematikat, siç e kuptuam ne. Ne kuptuam që na u kërkuan problematikat e hasura gjatë...


Znj. H. Vukaj: Unë s'kam asnjë problematikë të ekspozuar dhe të informuar në tryezën time apo në këtë tryezë.

Znj. J. Josifi: Është bashkëlidhur në email, është file-n "Problematikat e hasura me dokumentin provues të adresës për votuesit nga jashtë vendit", në emailin që ju ka përcjellë Sekretarja e Përgjithshme në orën 11.30.

Znj. I. Nano: Është kjo tabela me "Problematikat e hasura".

Znj. J. Josifi: E kemi marrë kërkesën tuaj të ditës së djeshme, pasdite i kthyem përgjigje. Kemi bërë një listë me problematikat që kemi evidentuar gjatë këtyre ditëve të regjistrimit, nëse do të duhet të kishim sjellë dhe statistikat e shqyrtimit të kërkesave. Nuk e vlerësuam se ato janë publike, "dashboard-i" përditësohet në kohë reale në fakt, janë shifrat që ju vetë referuat, sa kërkesa kanë ardhur dhe sa janë

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

shqyrtuar dhe po shqyrtohen deri më tani. Nëse dëshironi që t'i kalojmë problematikat me radhë, patjetër.

Znj. H. Vukaj: Do të dëshiroja që problematikat dhe tipologjitë, do të doja t'i dëgjoja nga ju dhe sesi e keni perceptuar ju aktin tonë, i cili është, të paktën akti që kur është vendosur kriter adresa dhe llojet e dokumentave, në mendimin tonë për sa miratuar atë akt, janë të qarta dhe është një gamë e gjerë dokumentash që japin mundësinë gjithkujt që të hedhë adresën. Unë i referohem një rasti të bërë mediatik, rastet e bëra mediatike janë pafund, i cili thoshte jam refuzuar për shkak se unë plotësova një dokument, për adresë vura dokument kontratë shtëpie e cila ekzistonte në emër të bashkëshortit. A e gjeni të përshtatur refuzimin në këtë rast?

Znj. J. Josifi: Në këtë rast lista e dokumentave, pra dokumenti i dorëzuar është në listën e miratuar nga ana juaj në vendimin nr.11, por të mos harrojmë që Kodi por edhe vendimi juaj nr.10 thotë se kërkesa për regjistrim është kërkesë, duhet të jetë kërkesë individuale e zgjedhësit...

Znj. H. Vukaj: Kërkesa për regjistrim individuale e zgjedhësve buron nga Kushtetuta e dashur dhe është e drejtë sublimë, që do të thotë individuale do të jetë ajo kërkesa, kurse ne dimë mjaft mirë që për të më ardhur zarfi unë do të vendos një adresë, e cila, do të vërtetojë që...

Znj. I. Nano: Që zgjedhësi përkatës është në atë adresë...

Znj. H. Vukaj: Po zgjedhësi përkatës është në atë adresë dhe nuk mund të më kufizojë sepse në të gjithë pothuajse, në të gjithë botën mund të jetë kështu,

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*


pavarësisht se tradita shqiptare mbizotëron te pjesa që gjithçka ose kryesisht mund të jetë në emër të kryefamiljarit kontratat apo dokumentacioni, por kjo ty të lidhet me atë pikën aty në fund, të gjashtë personave të cilët në mënyrë të përligjur provojuë që kanë të njëjtën adresë. Vaj halli për atë që ka apo banon momentalisht tek tezja apo tek daja apo tek biri dhe bija, te të afërm të tjerë, të cilët çfarë të bëjnë ata? Është dokumenti i tezes dhe unë nuk arrij dot të lidhem me këtë dokument si...

Znj. I. Nano: Më falni zonja Josifi! Atëherë pa ardhur te rasti konkret nëse mundet zonja Josifi, meqenëse dokumentacionin na e ka përcjellë, të lexonte problematikat e hasura deri tani dhe pastaj të ndalemi konkretisht apo dëshironi vetëm për këtë çështje që sapo shtruat shqetësimin?

Znj. H. Vukaj: Unë mendoj që zonja Josifi sot duhet të bëjë një panoramë, patjetër shqetësimi është shumëdimensional për shkak të medias dhe impaktit që ka dhënë. Zonja Josifi do të na bëjë së pari një panoramë sesi po ecën situata dhe a i përballojn dot administrata e KQZ-së këtë fluks dhe për aq kohë sa ka mbetur? Çfarë masash ka marrë dhe problematikat sesi e ka lexuar? Kjo shtrohet në këndvështrimin objektiv për të ndihmuar jo vetëm zonjën Josifi por njëkohësisht KQZ-në dhe mbarë shqiptarët që të kenë lehtësi. Pra të përmbushet parimi i lehtësisë që ne jemi të gatshëm, mendoj dhe ju kolegë në çdo kohë që mund të ndërhyjmë te vendimi ynë në qoftë se administrata këtu ka nevojë për interpretim apo zonja Josifi, ndërkohë ndërk këto ditë, në qoftë se do të kishte pengesa të të interpretuarit, të kuptuarit, mund të na kishte çuar dhe një shkresë zyrtare dhe ne të përgjigjeshim dhe të sqaronim sesi perceptohet dhe si kuptohet ai vendim i yni.

Znj. I. Nano: Dakord. Zonja Josifi ju lutem!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Znj. J. Josifi: Do t'i kthehem edhe problematikës që është në fakt në listën e problematikave që ju kemi përcjellë, dokumentin që përmendëm, është rreshti i parafundit, por unë po i marr me radhë. Kemi konstatuar kryesisht një problematikë ose moskuptim nga zgjedhësit që kërkojnë të regjistrohen dhe janë me banim, me qëndrim në Itali, si dokument provues të adresës ata kanë ngarkuar ID italiane, duke dërguar foto të saj të anës së përparme, ndërkohë që adresa gjendet e shënuar në pjesën e mbrapme të dokumentit të ID-së, kemi me qindra raste të tilla. Sërish në rastin e zgjedhësve, me qëndrim...

Znj. H. Vukaj: E keni bërë ju një sqarim publik që për emigrantët në Itali duhet të skanojnë apo të fotografojnë pjesën e mbrapme?


Znj. J. Josifi: Po, Komisioneri ka bërë një sqarim publik. Po e ka bërë Komisioneri këtë.

Znj. H. Vukaj: Aty i keni dhënë facilitetin dhe lehtësinë në këtë platformë që të kenë edhe shembuj?

Znj. J. Josifi: Jo, platforma është për përdorim për të, kemi në platformë kemi manuale përdorimi, kemi tutoriale...

Znj. H. Vukaj: E pamë se çfarë keni, po ju u keni dhënë mundësinë, domethënë kjo periudha që iu dha këtë lloj tipologjish, këtë lloj variacioni të dokumentacionit, të aplikimeve, etj., etj., ose pengesave ose moskuptimeve. A ju shtyu ju që të ndërhynit përmes firmës që ka ndërtuar këtë platformë edhe të implementonit elementë të tjerë lehtësues, duke implementuar shembuj? Ju të Italisë, për shembull, për emigrantët e

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Italisë fotografoni ku ndodhet adresa apo ju të Francës një tjetër, apo ju, pra fenomenin ta sqaronit me një shembull konkret. A e keni marrë këtë masë?

Znj. J. Josifi: Atëherë, konkretisht Komisioneri ka bërë një komunikim publik, specifikisht për rastin e Italisë, unë po jua lexoj shprehimisht, është konkrete problematika. Bazuar në këtë listë problematikash, atëherë: “Sqarim publik për zgjedhësit nga jashtë me qëndrim në Itali”, “Kujdes në rastin kur si dokument adrese ngarkoni dokument identifikues, të lëshuar nga shteti italian, sigurohuni që të skanoni anën e pasme të këtij dokumenti, anë e cila përmban të dhënën mbi adresën. Kujdesuni që skanimi i faqes së pasme të përfshijë patjetër edhe emrin tuaj.” Pra se do të lidhet me emrin e zgjedhësit, i cili ka bërë kërkesën. Ky është ky rast specifik. Po është për Italinë. Viojmë po në rastin e shtetasve me qëndrim në Itali, ka nga ata që kanë ngarkuar si provë sërish të adresës patentën e lëshuar nga shteti italian, e cila nuk e përmban fare si element adresën e shtetasit. Në rastin e Italisë, por ky është i përsëritur dhe në disa raste të tjera, por rast i rrallë realisht për nga volumi. Ka shtetas që kanë ngarkuar faturë blerje të një produkti, e cila në fakt e përmban emrin, mbiemrin e shtetasit si dhe adresën e tij, por nuk është në listën e dokumentacionit të miratuar nga ana juaj në vendimin nr.11, pra nuk është një faturë utiliteti, është një faturë blerje online. Pra dikush ka blerë një produkt. Ky është një rast tjetër. Nga Britania e Madhe kemi rastin që shtetasit ngarkojnë lejen e qëndrimit, e cila nuk e përmban adresën, pra thotë që zgjedhësi është atje, por jo se ku specifikisht. E njëjta gjë është rasti i Kanadasë. Ndërkohë fenomen që e kemi hasur në shtete të ndryshme, të qëndrimit është që shtetasit ngarkojnë pasaportë të lëshuar nga shteti përkatës, e cila nuk ka asnjë të dhënë për adresën, e kemi këtë në SHBA, e kemi në shumë vende. Kemi raste që janë ngarkuar, edhe këto janë të paktë në numër po ka disa raste, janë ngarkuar si provë adrese, foto e zarfave të jashtëm të postës, të cilat i kanë

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

të dhënat identifikuese të shtetasit dhe adresën, por nuk përbëjnë dokument, pra është thjesht një zarf i jashtëm. Ndërkohë kemi raste kur ata kanë tentuar të fotografojnë dokumentin provues të adresës por i kanë bërë “zoom in” pra kanë fotografuar vetëm atë pjesë të dokumentit ose atë sesion ku është adresa dhe emërtimi i tyre, por e palidhur, pra nuk duket dokumenti. Është si të marrësh vetëm kokën e dokumentit, pra një adresë, katër rreshta, është rasti që dhe ju vetë përmendët, që janë ngarkuar dokumente jo në emër të zgjedhësit.

Znj. H. Vukaj: Ju i keni refuzuar këto raste?

Znj. J. Josifi: Ne kemi raste po, që i kemi refuzuar sepse nuk e lidhim dot me zgjedhësin. Një dokument të lëshuar në emër të dikujt tjetër, si ta lidhim.

Znj. H. Vukaj: Po si e lexoni ju këtë vendimin tonë për shembull? Si e interpretoni?

Znj. J. Josifi: Vendimi juaj thotë që zgjedhësi bën kërkesë individuale për regjistrim dhe ai duhet ta provojë adresën e tij, adresën e deklaruar në ato fusha, sërish në sistem, me një dokument provues të adresës. Nëse ne kemi një kërkesë për regjistrim nga zonja Jona Josifi nuk mund të kemi ndërkohë një dokument nga zonja Doçaj, se nuk e lidhim dot me zgjedhësin që ka bërë kërkesën në sistem...

Znj. H. Vukaj: Ti po ndikon zonjë te e drejta për të votuar.

Z. M. Çakaj: Më fal po pse e refuzoni ju dhe mos t'i kërkonit një dokument shtesë, pse duhet ta refuzoni? E para. E dyta, në nenin 25 të Kodit Zgjedhor parashikohet që zgjedhësi për regjistrim duhet të paraqesë një dokument i cili provon qëndrimin

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

e tij jashtë. Në gjykimin tuaj zonja Josifi, nëse një zgjedhës që jeton dhe banon jashtë shtetit paraqet një dokument, në rastin konkret Anglisë “permanent resident”, leje qëndrimi a e provon kjo në respekt të Kodit Zgjedhor, në respekt dhe të vendimit nr. 10 të Komisionit Rregullator qëndrimin e tij, jetesën, banesën jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë?

Znj. I. Nano: Atë po, po jo adresën...

Z. M. Çakaj: Jo, jo një sekond, e pranon qëndrimin? Jo të më kthejë përgjigje, a e provon qëndrimin kjo?


Znj. J. Josifi: Po adresën e provon?

Z. M. Çakaj: Jo, jo, m’u përgjigj, e provon në kërkesën e Kodit Zgjedhor?

Znj. J. Josifi: Po e provon qëndrimin.

Z. M. Çakaj: Po e provon. Atëherë një sekond, vendimi ynë nr. 10 lidhur me listën e dokumentacionit ka të bëjë së pari, në mënyrë specifike për adresën se ku do i shkojë zarfi dhe po të shikoni te lista e dokumentave ne të gjithë unanim kemi vendosur që ose çdo dokument tjetër, i cili provon adresën ku do i vejë zarfi, jo qëndrimin, pra duhet të ndajmë dy koncepte, qëndrimin e tij, shtetasi shqiptar me banim jashtë vendit e provon me çfarëdo lloj dokumenti të huaj, qoftë kjo leje qëndrimi, qoftë patentë, qoftë dokument bankar, qoftë dokument komunal, qoftë çfarëdo lloj dokumenti tjetër, qoftë dhe ai dokumenti, zarfi i cili vjen nga një institucion. Ky dokument i shoqëruar me dokumenta të tjera e provon qëndrimin

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

jashtë shtetit dhe efekti ose më saktë dokumentacioni i cili duhet për adresën, është dokumentacioni i cili do t'i shërbejë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për të dërguar në mënyrë të saktë zarfin me fletën e votimit, kështu që unë i bashkohem shqetësimit të zonjës Vukaj lidhur me 16 000 aplikime dhe vetëm 2 400 pranime. Nëse ju vlerësoni që duhet të ndryshojmë diçka në vendimin tonë 9 apo 10 jemi këtu, jemi të gatshëm që në këtë moment që sot ta ndryshojmë, nëse shikoni pengesa ligjore. Unë personalisht nuk shikoj pengesa ligjore, është i qartë Kodi Zgjedhor, është i qartë dhe vendimi nr. 9 apo 10.

Znj. H. Vukaj: Pra e thënë thjesht ky refuzimi juaj lidhet me atë pikëpyetjen e riverifikimit edhe njëherë të identitetit apo legjitimitetit të asaj qendre banimi apo...

Znj. J. Josifi: Jo.

Znj. H. Vukaj: Po, po ashtu është.

Znj. J. Josifi: Sapo dhamë dy raste të ndryshme.

Znj. H. Vukaj: Jo, jo të lutem! Ajo ashtu është. Pra....

Znj. J. Josifi: Ju lutem, ju referuat...

Znj. H. Vukaj: Zoti Çakaj ndërhyri, dakord e bëri për analogji dhe për të ndërtuar logjikën, pra nuk mundesh të refuzosh zonjë rastin. Pra fenomeni nuk duhet të ekzistonte sepse vendimi është i qartë, dokumenta të tjera dhe dokumenta të lidhura, pra dhe dokumenta të lidhura, pra kjo nuk më ndikon mua në të drejtën për të votuar,

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

të drejtën time kushtetuese, nuk është vendqendrimi sipas “permanent resident” apo këtyre dokumentacionit që të jep mundësinë që të jetosh si rezident jashtë shtetit. Pra në rastin e një azilanti, i cili është pa dokumentacion dhe të servir ty një adresë, të nis një dokument, i cili dëshmon një adresë, e cila ndoshta s’është e tija, çfarë do të bëni zonjë, do t’i hiqni të drejtën për të votuar?

Znj. J. Josifi: Atëherë, ju lutem, t’i marrim rastet me radhë. Rasti i azilantit...

Znj. H. Vukaj: Më qëndro të lutem te ky rasti sepse është masiv, ky rasti...

Znj. J. Josifi: Cili nga rastet?

Znj. H. Vukaj: ... jo ky, fenomeni...

Znj. J. Josifi: I dokumentit në emër të një personi tjetër?

Znj. H. Vukaj: Më fal të lutem se unë jam këtu dhe e di ta shpjegoj rastin vetë. Rasti është ky që përbën fenomen, bashkëshorti është kryefamiljar, i cili mund të lidhë kontratën për një shtëpi, mund të lidhë kontratë për internetin, mund të ketë një dokument bankar, ku...

Znj. J. Josifi: Jam shumë dakord.

Znj. H. Vukaj: ... disponon dispozitat për të gjithë familjen.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Znj. J. Josifi: Jam shumë dakord po si të lidhim bashkëshortin me bashkëshorten, si ta lidhim? Pra kemi një kërkesë të dorëzuar nga bashkëshortja dhe kemi një kërkesë një dokument nga bashkëshorti, ta marrim me mend këtë?

Z. M. Çakaj: Po jo pra, është shumë e thjeshtë znj. Josifi, tani dokumenti i pronësisë mund të jetë vetëm në emër të njërit, mund të jetë në emër të të dyve. Në rastin konkret nëse bashkëshortja paraqet...

Znj. J. Josifi: Shumë dakord, si ta lidhim bashkëshortin me bashkëshorten?

Z. M. Çakaj: Po e ka deklaruar adresën, nëse bashkëshortja ka paraqitur një dokument që provon qëndrimin jashtë shtetit, banesën jashtë shtetit, atëherë automatikisht me deklarinimin që ka bërë të adresës është i pranuar, nuk duhet as të refuzohet. Kam dhe një shqetësim tjetër.

Znj. H. Vukaj: Si e lidh ti nipin me dajën për shembull, si duhet ta lidhim? Çfarë i kërkon atij zotërisë?

Znj. I. Nano: Po s'lidhen fare, secili do të paraqesë dokument që lidh veten e vet, me adresën që ka deklaruar...

Znj. H. Vukaj: Zonja Nano unë s'kam nevojë të jepni mend në këtë diskurs. Unë i ngre retorikat sepse janë të interesuar shqiptarët zonjë.

Znj. I. Nano: Patjetër dhe unë për shkak të interesit të shqiptarve po flas.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Znj. H. Vukaj: Kur të keni ju pyetje, kjo s'është interes i shqiptarve, ju po më pengoni, ju po pengoni që unë dhe të tjerë, të lutem mos ndërhy...

Znj. I. Nano: Të lutem, unë s'po pengoj fare njeri, po ju jap gjithë hapësirën për të diskutuar.

Znj. H. Vukaj: Të lutem mos ndërhy, hapësirën e kam.

Znj. I. Nano: Si lidh nipin me dajën, në funksion të ...

Znj. H. Vukaj: Zonjë nuk ta bëra ty pyetjen. Unë retorikën e ngre në funksion të logjikës. Çfarë kemi thënë në atë vendim ne zonja Nano?

Znj. I. Nano: Po kemi thënë që do të aplikojnë individualisht, do të deklarojë adresën individualisht dhe që do të paraqesin, secili...

Znj. H. Vukaj:...do ta deklarojë individualisht, jo adresën individuale, po adresë individuale se s'ka adresa inividuale, adresa mund të jetë e gjithë familjes...

Znj. I. Nano: Adresën ku qëndron.

Z. M. Çakaj: Numri 6.

Znj. I. Nano: Numri 6, më shumë se kaq, me të njëjtin dokument, me të njëjtën adresë...

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Znj. H. Vukaj: Po pikërisht pra, si lidhen ata me njëri-tjetrin?

Z. M. Çakaj: Në të njëjtën adresë, jo të njëjtin dokument.

Znj. I. Nano: Mund të jenë gjashtë dokumenta të ndryshëm...

Z. M. Çakaj: Nëse...

Znj. H. Vukaj: Po pikërisht pra, do të kërkojmë dokument të legjitimuar kemi thënë.

Znj. I. Nano: Po pra dokument që vërteton, që zgjedhësi...

Znj. H. Vukaj: Po prandaj e bëra pyetjen.

Znj. I. Nano:... zgjedhësi ka të njëjtën adresë të cilën e ka deklaruar kur ka hyrë në PER.


Znj. H. Vukaj: Po prandaj e bëra pyetjen zonjë, që legjitimon lidhjen duhet t'i kërkonit, përpara se ta refuzoni.

Z. M. Çakaj: Më fal, ja vetëm një sekond.

Znj. I. Nano: Ja të mbarojë z. Çakaj.

Z. M. Çakaj: Në respekt të kësaj e kisha dhe çështje për diskutim. Në respekt edhe të vendimit që ne kemi miratuar, vendimit nr. 9 dhe listës së dokumentave vendimi

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

nr. 10 i Komisionit Rregullator që çdo zgjedhës do të aplikojë në mënyrë individuale. Në dijeninë time Komisioni Rregullator, nuk e di çfarë ka bërë administrata apo Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nuk ka nënkontraktuar asnjë person të tretë, qoftë edhe parti politike, siç është rasti i z. Peleshi, që është gjerësisht i publikuar në media, të krijojë një zyrë, e cila të asistojë zgjedhësit shqiptarë për t'u regjistruar. A është shkelje kjo, qoftë e vendimeve tona? A mund të konsiderohet dështim i KQZ-së kjo? Sepse ne nuk kemi autorizuar asnjë parti politike, PS, PD, PL, PSD, kushdo parti që të kryejë punën e KQZ-së. Një nga parimet që ne kemi vendosur në vendimin nr. 9 është parimi i thjeshtësisë së aplikacionit dhe aplikohet në mënyrë individuale regjistrimi. Ç'punë ka një parti politike të regjistrojë, të asistojë, a është kjo blerje vote? A është ky ndikim? Në gjykimin tim KQZ-ja urgjentisht duhet të marrë masa ta pengojë, ta ndalojë këtë proces sepse është në kundërshtim me Kodin Zgjedhor, është në kundërshtim të hapur me çdo vendim të Komisionit Rregullator lidhur me votimin nga jashtë, që kryhet pasi regjistrohen shqiptarët dhe nëse ka ndonjë akt, ndonjë ndryshim, i cili ju e gjykoni të arsyeshme që ne ta marrim, ta ndryshojmë vendimet tona jemi të hapur, shprehim gatishmërinë në funksion të regjistrimit sa më masiv të zgjedhësve shqiptarë jashtë vendit. Është një proces, i regjistrimit që duhet inkurajuar, nëse ka diçka për ta thjeshtuar, hajde ta shtjeshtojmë, nëse ka diçka për ta nxitur shumë dakord, por jo të bëhemi barrierë për emigrantët që duan të regjistrohen.

Znj. H. Vukaj: Po i referohem, meqenëse kemi dhe median prezent këtu, vendimit nr. 10, në mënyrë eksplicite, thotë te kreu II, "Lista e dokumentacionit që kërkohet për të vërtetuar qëndrimin e zgjedhësit", "Shqiptarët që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim regjistrimin në listën e zgjedhësve jashtë vendit. 1. Gjatë paraqisjes së kërkesës tij për regjistrim në listën e zgjedhësve jashtë vendit,

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

sipas rregullave të miratuara nga Komisioni Rregullator zgjedhësi ngarkon në platformën elektronike të regjistrimit PER të paktën një nga dokumentat e listuara më poshtë që vërteton qëndrimin e tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë” dhe nuk e ndikon, nuk e kushtëzon, kërkon vetëm një dokument, pra që t’i japë siguri KQZ-së ku ta çojë zarfin. Një moment të lutem, unë s’kam mbaruar. “a. Dokument pronësie ose ekuivalent”, nuk është e thënë zonjë që ky dokumenti i pronësisë ose ekuivalenti i tij të jetë në emrin e tij, po të jetë një faktor për të thënë që kjo adresa është e saktë, është e sigurtë, pra e pres zarfin në këtë adresë dhe është e pakushtëzuar, këtë vëreni vath në vesh sepse keni bërë gafën më të madhe me këto refuzime që keni bërë. “b. Dokument që provon rezidencën në shtetin e huaj, i lëshuar nga autoritetet përkatëse”, “c. Kontratë qiraje ose huapërdorje të banesës”, “ç. Dokumente bankare ku përfshihen kontratë kredie, vërtetim bankar që përmban adresën e banimit”, “d. Kontratë furnizimi ose faturë të furnizimit me ujë në banesë”, “dh. Kontratë furnizimi ose faturë të energjisë elektrike ose gaz në banesë”, “Kontratë ose faturë të abonimit të shërbimit digjitalb apo të transmetimeve audiovizive”, “Kontratë ose faturë të ofrimit të shërbimit të internetit të telefonisë fikse në banesë”, “Leje drejtimi automjeti, në rastet kur shënohet adresa e banimit”, “Dokument të lëshuar nga organi kompetent i shtetit ku ka vendbanimin, i cili vërteton qëndrimin e zgjedhësit në një institucion shëndetësor, kamp emigracioni apo tjetër të ngjashëm” ose “Çdo dokument tjetër” thotë pika “h”, “i lëshuar në shtetin e huaj që provon qëndrimin e shtetasit shqiptar në adresën e vetëdeklaruar jashtë vendit.” “2. Numri i shtetasve shqiptarë të regjistruar në të njëjtën adresë që aplikojnë në platformën PER, në listën e zgjedhësve nga jashtë, nuk mund të jetë më shumë se 6. Vetëm për shkaqe të përligjura dhe pas paraqitjes së dokumentacionit provues ligjor, PER do të lejojë regjistrimin në të njëjtën adresë të më shumë se 6 shtetasve.” E kuptoni sesa e hapur dhe gjithëpërfshirëse është kjo me kaq sa lexova

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

dhe e pakushtëzuar zonjë? Pra janë ato dy parime që unë cekta që në fillim, parimi i gjithëpërfshirjes dhe parimi i lehtësisë. Më jepni përgjigje tani zonjë sesi do të jetë mbarëvajtja e këtij procesi kur ne shikojmë një numër të llahtarshëm aplikimesh ku ju u jeni përgjigjur me pikatore. Nga 16 090 ju u jeni përgjigjur 2423, a thua se kemi luksin dhe zgjedhjet janë pas katër viteve dhe jo pas katër muajve e më pak.

Znj. J. Josifi: Atëherë nëse i referoheni marzhit ose ritmit të shqyrtimit të kërkesave, edhe mendoni që mund të kishte qenë më i shpejtë deri në këto tre-katër ditë, regjistrimi është hapur ditën e shtunë, sot është e mërkurë, ne jemi duke i trajtuar të gjitha kërkesat edhe me orare të zgjatura. Ishte dhe fillimi në fakt dhe ne donim të ishim të kujdesshëm në trajtimin e kërkesave të para sepse donim edhe të shikonim problematikat që janë këto që edhe ju kërkuat dhe këto që dhe ne kemi studiuar në një farë mënyre gjatë këtyre ditëve të para. Ne nuk kemi tejkaluar, sot që flasim, afatin ligjor, ne jemi brenda afatit ligjor për shqyrtimin e kërkesave, që është 5 ditë nga marrja e kërkesës. Nga 16 145 ...

Znj. H. Vukaj: Sa vetave u ka kaluar afati pesë ditor dhe sa janë brenda afatit pesë ditor?


Znj. J. Josifi: Askujt! Asnjë, janë të gjithë brenda afatit pesë ditor.

Znj. H. Vukaj: Mirë pra mirë. Jeni në gjendje ju që të kuptojnë shqiptarët...

Znj. J. Josifi: Po pra më lini të sqaroj...

Z. M. Çakaj: Atëherë një pyetje konkrete për ju...

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Znj. J. Josifi: Po ju lutem ma lini ta mbaroj, më lejoni t'u përgjigjem pyetjeve.

Z. M. Çakaj: Dakord do të keni kohën të përgjigjeni, tani procesi është dinamik të lutem. Në ditën e parë kanë qenë 3600 e ca aplikime, ju keni shqyrtuar deri më sot vetëm 2413 diçka e tillë. Ju mendoni...

Znj. J. Josifi: Ta saktësoj të lutem këtë shifër? Ju po i referoheni vetëm shifrës së miratimeve, ndërkohë në “dashboard” djathtas, tabela e tretë ka miratime, refuzime, miratime kur kërkohet dokument i ri, pra miratime të shtetasve që kanë aplikuar me dokument jo të vlefshëm si dhe të shtetasve të cilët kanë aplikuar dhe iu është miratuar kërkesa me dokument të pavlefshëm dhe e kanë përditësuar dokumentin. Pra ne kemi shqyrtuar...

Z. M. Çakaj: Atëherë meqë kemi, meqë më cilësove “dashboard-in”, e keni ju opsionin “në pritje”?

Znj. J. Josifi: Ne kemi shqyrtuar...

Z. M. Çakaj: Se ju keni o “miratim”, o “refuzim”, në “dashboard” nuk e ka “pending”, unë e kam provuar.

Znj. J. Josifi: E keni është në shqyrtim, është “pending”...

Z. M. Çakaj: Jo, atëherë këtë e them me përgjegjësi, se e kam provuar unë, meqë jam dhe rezident jashtë shtetit, e kam provuar dhe ju e dini shumë mirë që e kam

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

provuar të regjistrohem vetë nga jashtë vendit, ju keni në platformën PER, ju keni ose “mbaro aplikimin”, ose nëse unë do të riaplikoj do të duhet ta filloj, ta rifilloj nga fillimi. Të lutem ma konfirmo këtë gjë? Sepse kështu është procesi, platforma elektronike e regjistrimit ka ose miratim ose refuzim, nuk e ka “pending”, nuk mund të qëndroj një shtetas shqiptar që aplikon për regjistrim jashtë vendit, nuk mund të qëndrojë në të njëjtën fazë. Pra nëse ju i kërkon të përditësojë të dhënat në një dokument, atëherë këtë nuk ta lejon aplikacioni, a mund të bëhet kjo në këtë moment të aplikacionit? Pra shtetasi që gjendja e shtetasit, që nga momenti i regjistrimit shtetasi të rrijë në pritje deri në pritje të momentit e plotësimit të të dhënave, është e mundur teknikisht të bëhet?

Znj. J. Josifi: A është e mbështetur në rregullat e regjistrimit kjo kërkesë?

Z. M. Çakaj: Pse çfarë problemi ka? Patjetër, ti je... Termi ligjor shqyrtim pikërisht këtë gjë do të thotë dhe shqyrtimi nuk është proces i cili fillon e mbaron, shqyrtimi është proces dinamik, ti shqyrton gjithë dokumentacion dhe nëse ka nevojë për dokumentacion shtesë ne kemi thënë që zgjedhësi shqiptar e ka dhe Kodi, edhe ne te vendimi, zgjedhësi shqiptar me banim jashtë vendit komunikon nëpërmjet PER-i me KQZ, pikërisht këtë nënkupton komunikimi. Pra nëse unë nuk kam dokumentacionin e saktë për regjistrim, atëherë nëpërmjet PER-it më komunikohet dhe automatikisht unë paraqes dokument shtesë dhe kjo nënkupton statusin në pritje të shqyrtimit, pse duhet të jetë bardh e zi ka dhe ngjyra në mes.

Znj. I. Nano: Mos ndoshta se janë dy momente të ndryshme z. Çakaj, pra kur nuk është përfunduar kërkesa e zgjedhësit me gjithë dokumentacionin dhe kur është

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

përfunduar kërkesa dhe është në shqyrtim nga KQZ-ja, janë dy momente të ndryshme.

Z. M. Çakaj: Po çfarë i duhet zgjedhësit nga jashtë, është përfunduar apo jo?

Znj. I. Nano: Jo, kërkesa, jo shqyrtimi, është moment tjetër.

Z. M. Çakaj: Kërkesa për regjistrim, çfarë i duhet zgjedhësit nga jashtë, pse duhet të presë zgjedhësi nga jashtë pesë ditë, ndërkohë që këtu nuk kemi... Shiko e di si është puna.

Znj. I. Nano: Pesë ditë e kemi lënë ne afatin, është për çdo rast.

Z. M. Çakaj: Po pse pesë ditë, i refuzohet kërkesa për regjistrim dhe i thuhet provo përsëri. Shiko ka një problem, tani do t'i kemi thënë procesi duhet të jetë i thjeshtë, po s'është i thjeshtë, nuk është i thjeshtë.

Znj. I. Nano: Është i thjeshtë.

Z. M. Çakaj: Nuk është i thjeshtë, fakti që janë paraqitur deri më sot dhe sot s'është as ditë e tretë as ditë e katërt, është dita e pestë sot e procesit të regjistrimit dhe sot mbaron afati për ata 3600 kërkesat e para dhe unë dyshoj fort nëse numri 2400 do të shkojë 3600, lidhur me shpejtësinë e shqyrtimit të aplikimeve nga stafi i KQZ-së. Çfarë ju duhet, çfarë keni nevojë? Të paktën nga Komisioni Rregullator, keni nevojë për ndonjë ndryshim, amendim, nxitje, çfarë kërkohet, në mënyrë që të procesojmë sa më shpejt.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Znj. H. Vukaj: Sa operatorë kanë qenë të angazhuar që nga dita 1 e hapjes së këtij procesi, sa janë sot?

Znj. J. Josifi: Nga dita e parë e hapjes së këtij procesi kanë qenë të angazhuar 7 operatorë, sot janë 22.

Znj. H. Vukaj: Kur e filluan punën këta 22?

Znj. J. Josifi: Me turne, sot.

Znj. H. Vukaj: Sot kanë filluar 22, gama e operatorëve është 22. Këta 7 ishin operatorë të trajnuar apo ishte stafi i KQZ-së?

Znj. J. Josifi: Stafi i përhershëm i Drejtorisë së Votimit nga Jashtë në KQZ.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Znj. H. Vukaj: Ju, gjatë pyetjeve që iu kemi bërë, keni thënë: “Kemi marrë operatorët i kemi trajnuar do marrin certifikimin përkatës”, pra keni dhënë garancinë që ky proces ishte tashmë i vënë në ingranazhe.

Znj. J. Josifi : Po patjetër, kishim nxjerr thirrjen për të marrë personel shtesë për shqyrtimin e kërkesave për rregjistrim, erdhën thirrjet u trajtuan janë lidhur kontratat.

Znj. H. Vukaj: Kur është bërë thirrja dhe angazhimi, sot?

Znj. J. Josifi: Javën e kaluar. E kemi diskutuar edhe në mbledhjen tuaj më të fundit, më lejoni të gjej datën. Thirrja është bërë përpara.

Znj. H. Vukaj: Përpara datës 11 është bërë thirrja?

Znj. J. Josifi: Në datë 30 dhjetor ka qenë mbledhja e fundit.

Znj. H. Vukaj: Nuk ka rëndësi, dhe u rekrutuan tani?

Znj. J. Josifi: Po.

Znj. H. Vukaj: Po pse nuk kanë filluar më parë këta?

Znj. J. Josifi: Kanë nënshkruar kontratat, kanë firmosur deklaratat e konfidencialitetit...

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Znj. H. Vukaj: Kur u trajnuan këta njerëz, që sot lidhet kontrata?

Znj. J. Josifi: Gjatë këtyre ditëve zonja Vukaj, që në momentin që ka filluar rregjistrimi që ditën e Shtunë. Pra, ne donim që të hapej rregjistrimi....

Znj. H. Vukaj: Pra, i kishit disponibël këta operatorë që ditën e shtunë po i trajnuat gjithë këtë periudhë kur ju vetë dëshmoni....

Znj. J. Josifi: Nuk është gjithë kjo periudhë, janë katër ditë.

Znj. H. Vukaj: E di si i duken shqiptarëve këto katër ditët?! Katër muaj.

Znj. J. Josifi: Ne donim që ata të familjarizoheshin konkretisht me rastet.

Znj. H. Vukaj: Katër muaj i duken, të garantojë për këtë pjesën. Nga dinamika e gjithë kësaj game të gjerë që po shohim në media, teknikë të ndryshëm që dalin dhe shpalosin mendimet e tyre, pikëpyetjet e tyre, pikëçuditëset e tyre e kështu me rradhë. Jo më larg se dje unë konkretisht dëgjova intervistën e një përfaqësuesi të “Diasporës për Shqipërinë e Lirë”, i cili ngrinte problematika të cilat thoshte ja kam servitur që në datën tre dhe nuk shoh që janë sistemuar apo akomoduar.

Znj. J. Josifi: Në fakt problematikat e ngritura nga “Diaspora për Shqipërinë e Lirë” të datës 3 Janar janë adresuar dhe adresimi i tyre është dokumentuar me datën 9 Janar me shkrim nga ana jonë. Ata mundet tua konfirmojnë këtë. Kemi pasur një takim sqarues dje në fakt dhe të gjitha problematikat e tyre ose rastet, çështjet që lidheshin edhe me faqen e ndërpërdoruesit edhe me elementët e sigurisë edhe me use

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

keys janë adresuar me datën 9 janar. Kanë qenë aktive në sistem të adresuara që nga sekonda e parë e fillimit të rregjistrimit. A mundet ti përgjigjem pyetjeve ju lutem siç u ngritën?

Znj. I. Nano: Unë doja të shtoja diçka zonja Josifi përpara. Pa dyshim që ne kemi shumë aktorë të përfshirë dhe grupe interesi, po mos të vijë puna që të merremi vetëm me një grup interesi të caktuar. Kur të na dalin kandidatë potencialë për deputet dhe më duket pastaj se nuk e kanë në emër të atyre se çfarë përfaqësojnë por në emër të vetes së vet. Ndërkohë do ti përgjigjeshe pyetjeve kam edhe unë një diçka tjetër...

Znj. H. Vukaj: Kishit ndonjë rast konkretë zonja Nano për kandidatët potencial...

Znj. I. Nano: Kandidatë potencial thashë. Tani 50 ditë përpara zgjedhjeve do ti mësojmë kandidatët për deputet.


Znj. H. Vukaj: Ju që e proklamoni këtë, ju e paskeni informacion na i thoni të paktën.

Znj. I. Nano: Domethënë unë nuk duhet të flas fare të mos jap asnjë mendim.... Aktorët më të interesuar këtu janë partitë politike...

Znj. H. Vukaj: Akotërët më të interesuar janë tyë gjithë shqiptarët sepse bëhet fjalë për një të drejtë kushtetuese pronë publike.

Znj. I. Nano: Partnerët e drejtëpërdrejtë me KQZ-në janë partitë politike. Ne jemi KQZ.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Znj. H. Vukaj: Jemi edhe ne të interesuar që miratojmë aktet të cilat keqinterpretohen apo...

Znj. I. Nano: Ne jemi KQZ-ja. Me KQZ-në janë partitë politike.


Znj. H. Vukaj: Po KQZ-ja jemi, që miratojmë aktet dhe kjo bëhet në funksion të akteve tona dhe shërbimit...

Znj. I. Nano: Unë nuk e di çfarë ju shqetëson në deklaratën time ose në atë çfarë thashë unë.

Znj. H. Vukaj: Jo, thjesht doja për transparencë domethënë ku e pe gjithë këtë, ndërkohë që kjo është për të gjithë shqiptarët. Ku e pe gjithë këtë një anshmëri të ndërhyrjeve tona, kjo ishte në shërbim të shqiptarëve.

Znj. I. Nano: Jo tuajave, unë fola për grupe interesi. Ne nuk jemi grupe interesi ne jemi pjese pjesë përbërëse jemi organ drejtues i KQZ-së. Flas për grupe interesi që nesër pasnesëe mos na dalin me interes “personal” jo në emër të asaj që thonë që përfaqësojnë. Zonja Josifi ndërkohë që do ti përgjigjeni pyetjeve të kolegëve kam edhe unë një pyetje që besoj që plotëson këto pyetje. Duke qenë si juriste duke qenë se me datë 11 filloi rregjistrimi afati 5 ditor për shqyrtimin fillon të nesër brenda 5 ditëve unë e llogaris nesër përfundimin e afatit 5 ditor të shqyrtimit. Në raport me atë që edhe kolegu Çakaj edhe kolegja Vukaj thanë nga data 11 atyre që i përfundon afati i shqyrtimit të kërkesave nesër. Sa prej tyre do arrini ti jepni përgjigje qoftë

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

edhe në kuptimin, miratuar, refuzuar e të tjera me rradhë,po ne kuptimin e shqyrtimit?

Znj. J. Josifi: Do respektojmë afatin ligjor do ta përfundojmë shqyrtimin për të gjithë në këtë rast kërkuesit e ditës së parë. Ne në fakt kemi ecur edhe me shqyrtimet e kërkesave të ardhura në ditën e dytë sa konstatoam edhe gjuhët në të cilat kishin ardhur dokumentet provues të adresës pra ato çfarë ishin të qarta, kemi procesuar menjëherë. Kishim nevojë për ndihmë në një ose dy gjuhë deri sa u sistemuar me burime njerëzore për nevojën specifike jemi duke ecur. Nuk jemi kursyer as në kuptim të kohës as në kuptim të përpjekjeve, qëllimi jonë është që tui shqyrtojmë edhe ne duam që ti shqyrtojmë kërkesat mundësisht sapo vijnë është thjesht çështje objektive dhe jemi duke punuar për këtë. Problematika siç ju thashë, ritmi do të jetë më i shpejtë sa më shumë që kalojnë ditët sepse ju thashë që ishin ditët e para. Edhe ne vetë donim të kuptonim, donim të shikonim tipologjinë, donim të kuptonim si e kishte kuptuar zgjedhësi, kemi shumë nga ato refuzime që janë aty që janë në sistem...

Znj. H. Vukaj: Ju vetë pas leximeve që i bëmë aktit e kuptuat se si duhet ti trajtoni zgjedhësit, që hedhin një të dhënë për dokument nj i cili nuk është në emër të tyre e kuptuat këtë pjesën? Se kjo është shumë e rëndësishme se lidhet me refuzimin.

Znj. J. Josifi: 430 refuzimet që janë aktualisht....

Znj. H. Vukaj: Po pra, po e kuptuat ju këtë pjesën e dokumentacionit që lexova? Se duhet ta kuptoni ju, që ta kuptojnë operatorët edhe kështu me rradhë, të mos i refuzohet.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Znj. J. Josifi: 98% e refuzimeve që kemi bërë kanë qenë për arsyen sepse zgjedhësit si provë të adresës kanë dhënë foto të dokumentit të identifikimit shqiptar. Këto refuzime kemi bërë. Çdo gjë tjetër të cilën ...

Z. M. Çakaj: Më fal një pyetje shtesë. E mundëson platforma elektronike rregjistrimit opsionin ngarko dokument shtesë në funksion të kësaj. Se ai mund ta ketë keqkuptuar dhe ka ngarkuar dokumentin e identifikimit shqiptarë. Ndërkohë që duhet të ngarkojë një dokument që provon qendrimin e tij jashtë. E mundëson këtë?

Znj. I. Nano: Për më tepër që ne e kemi të paktën një nga dokumentet. Kështu që mundet të ngarkojë dy apo më shumë dokumente.

Z. M. Çakaj: E mundëson?

Znj. J. Josifi: Nga momenti që kërkesa është dërguar nga zgjedhësi ajo mbërrin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në këtë rast do të duhet që ne ta shqyrtojmë atë, pra ta miratojmë ose refuzojmë që ai të vijojë plotësimin. Pra, në momentin që kërkesa ka ikur nga ai, e ka dërguar kërkesën nuk ka si të shtojë dokument kur kërkesa është dërguar tashmë.

Z. M. Çakaj: Atëherë, unë këtu konstatoj...

Znj. I. Nano: Pa e dërguar kërkesën a mund të ngarkojë më shumë se një dokument

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Z. M. Çakaj: Edhe pasi e ka dërguar kërkesën, unë këtu konstatoj një paqartësi teknike sepse edhe në momentin që zgjedhësi nga jashtë kanë ngarkuar një dokument. Në gjykimin dhe vlerësimin tim për hirë të thjeshtësisë së procesit edhe pasi ka shtypur butonin përfundo kërkesën për rregjistrim, platforma elektronike e rregjistrimit do të duhet të mundësoj të ngarkojë një dokument shtesë. Në funksion të zgjidhjes së çështjes.

Znj. J. Josifi: Në faskt nuk ka asnjë paqartësi teknike në gjykimin tonë, vendimi juaj nr. 10 kreu 4 shqyrtimi i kërkesave pika 1 lidhet me afatet, pika 2 : “Shqyrtimi i kërkesës për shqyrtim bëhet si vijon: a) PER përmes ndërveprimit në kohë reale me KQZ-në kontrollon vlefshmërinë, b)...

Z. M. Çakaj: Këtë që sapo thoni juve nuk e keni realizuar ju lutem. Zonja Josifi ne kemi miratuar që PER ndërvepron, ndërkohë që ju nuk e lejoni mundësimin e ndërveprimit, ju thoni përfundon kërkesën dhe nuk ndërvepron. Pra, i refuzohet kërkesa dhe ai duhet të rifillojë përsëri aplikimin nga e para.

Znj. I. Nano: Zoti Çaka e ka fjalën.

Z. D. Çaka: Zonja Josifi, si e kuptova unë pyetjen e zotit Çakaj. Se me të vërtetë ju thoni që në momentin që shtetasi e ka bërë kërkesën në atë moment po themi është mbyllur. Marrim një rast në një moment që unë si shtetas që ndodhem jashtë kam depozituar kërkesën pranë PER-it dhe kam ngarkuar një dokument i cili nuk e provon adresën. Por ndërkohë kërkesa ime nga ana e KQZ nuk është procesuar akoma, pra Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka dalë me një vendim por ndërkohë unë qoftë në mënyrë individuale ose qoftë nga media vë re që kërkesa ime është e pa plotë.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Gjatë kësaj periudhe nga momenti që unë e kam dorëzuar kërkesën dhe ju nuk keni disponuar me vendim ka një opsion PER-i për të ngarkuar një dokument shtesë, besoj që kjo ishte...

Z. M. Çakaj: Jo vetëm kjo, por besoj aplikantit i jepet arsyeja e refuzimit?

Znj. J. Josifi: Po patjetër. Atëherë pika 3: “Nëse kërkesa për rregjistrim plotëson për sa përcaktohet në pikën 2 të këtij kreu. Pra, ndërveprimi në kohë reale përputhshëmria e të dhënës biometrike, dokumentacioni adresës atëherë, zgjedhësi rregjistrohet në listën e zgjedhësve. Nëse të paktën një nga kushtet e përcaktuara në pikën 2 të këtij kreu nuk plotësohet kërkesa për rregjistrim nuk pranohet. Vendimi për mos pranimin duhet të përmbajë edhe shkaqet e mos pranimit”. Ju lutem kjo është kjo është pyetja. Vendi që i shkonzgjedhësit, njoftimi që atij i shkon me sms nëse ka zgjedhur të përdorë numrin e telefonit ose me email dhe të cilin e ka edhe kur hynë në llogarinë e tij se krijoi llogarinë, dërgoi kërkesën dhe rihynë në llogari sa herë që të dëshirojë e ka arsyen e refuzimit dhe ka një vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Ka edhe arsyen në krye të faqes dhe nëse shtyp butonin më shumë informacion dy butona ka në rastin e këtij zgjedhësi që i është refuzuar kërkesa apliko përsëri dhe më shumë informacion. Më shumë informacion i shfaqet i gjithë vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve i arsyetuar. Vijon vendimi juaj pika 4 “ vendimi mbi shqyrtimin e kërkesës pra ky që sapo thamë për mos pranimin i njoftohet zgjedhësit në llogarinë e tij në PER ose në adresën në email pra kështu siç është duke ndodhur aktualisht është lehtësisht e verifikueshme nga të gjithë zgjedhësit të cilëve i është refuzuar. Fjalja e dytë, llogaria e tij mbetet aktive dhe e aksesueshme në çdo kohë me qëllim plotësimin e dokumentacionit të munguar.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Pra, zgjedhësi hynë në llogari dhe risjellë dokumentin në këtë rast të adresës. Sistemi e ka përkthyer...

Z. M. Çakaj: Qartë, qartë. Nga përgjigja juaj...

Znj. J. Josifi: Gërmë më gërmë vendimin tuaj...

Z. M. Çakaj: Qartë, unë dyshoj nëse e ka përkthye por nga përgjigja juaj shteruese. Unë personalisht arrij në përfundimin që PER ose e pranon kërkesën ose refuzon e para...

Znj. J. Josifi: Sepse kështu thonë rregullat e vendimit numër 10.

Z. M. Çakaj: Jo nuk thonë kështu, se nuk e keni lexuar drejtë...

Znj. J. Josifi: Po ju lutem sapo e lexova me zë...

Z. M. Çakaj: Ja ta them unë pse nuk thonë kështu, do të jap edhe arsyetimin edhe logjiken pse nuk thonë kështu. Çfarë keni shkelur ju në implementim. Së pari procesi nuk është i thjeshtë, se e kam provuar vetë, nuk është i thjeshtë, së dyti PER nuk e di çfarë lloj teknologjie keni zgjedhur, PER nuk zbaton pikën e përcaktuar në vendimin tonë, numër 9 që ndërvepron me zgjedhësit. Nuk ndërvepron PER me zgjedhësin thjesht merr kërkesën dhe e shqyrtojmë ne të themi po ose jo. Patjetër me arsye, po nuk është qëllim ne vetvete refuzimi. Qëllim në vetvete është rregjistrimi i zgjedhësve ne këtu si KQZ kemi rolin të ndërmjetësor, të thjeshtëzojmë procesin që këta zgjedhës nga rregjistri pasiv i zgjedhësve brenda vendit me vullnetin e tyre

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

të kalojë në rregjistrin aktiv të zgjedhësve jashtë vendit. Ne duhet ta thjeshtëzojmë procesin jo të bëhemi barrierë, nëse ne nuk i japim opSIONIN ngarko dokument tjetër ose japim përgjigje të fiksuara definitive dyshoj se kështu mund të jetë sistemi. Atëherë, ne nuk e kemi arritur qëllimin e parimit të thjeshtësisë. Nuk kemi arritur qëllimin që na ka ngarkuar ligjvënësi që ne të jemi një ndërmjetës të thjeshtëzosh procesin, ta bësh sa më të lehtë procesin, sigurisht nuk kemi arritur gjithëpërfshirjen nuk kemi arritur edhe lehtësinë e rregjistrimit. Në këtë kuadër ne po shtrojmë pyetjen po marrim përgjigje, po arrijmë në konkluzione dhe hajde ta bëjmë më të mirë procesin. Unë propozoj që ju ta merrni në konsideratë thjeshtimin e këtij procesi, nëse është e mundur edhe teknikisht të shtohet edhe opsioni shtu edhe dokument shtesë. Pra, mos ti refuzohet kërkesa, nuk është qëllimi i KQZ-së të refuzojë kërkesa, refuzimi i kërkesës do të jetë vetëm në raste ekstreme. Në raste kur zgjedhësi ose kërkon të manipulojë sistemin ose është e vërtetë që nuk disponon asnjë lloj dokumenti. Nëse zgjedhësi me vullnetin e tij dhe me veprime pro aktive zgjedhësi shqiptarë jashtë vendit tregon që është rezident në një shtet tjetër të huaj dhe ngarkon një dokument të shtetit të huaj. Atëherë, platforma, KQZ duhet ta ndihmojë atë për të arritur qëllimin e rregjistrimit për të arritur qëllimin e dërgimit të zarfit me postë dhe në këtë kuadër edhe ajo zarfi që i vjen një dokument ku shkruhet adresa e shtetasit shqiptarë me banim jashtë vendit shërben si dokument, sepse ai e ka shprehur vullnetin, shërben për t'ia nisur ti zarfin me postë me fletën e votimit.

Znj. H. Vukaj: Mund të shtojë diçka në vazhden e gjithëçka ngritëm. Në këtë kuadër pra të parimit të lehtësisë dhe çfarë shtroi kolegu dhe së fundmi propozoi do tu thosha që ju jeni ende në kohë që të merrni masa për çfarëdo nevoje që të keni në drejtim të interpretimit, në drejtim të ndërhyrjes në akt, në drejtim të lehtësimit më shumë, të na propozoni në çdo kohë, me qëllim që të arrihet qëllimi i këtij procesi

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

dhe mos të shëndërroheni në gjykatë themeli ku ju të shqyrtoni dhe ti hyni themelit të një dokumentacioni pa qenë minimalisht jurist. Kështu që jeni në kohë për tu angazhuar dhe për të na vënë në lëvizje kur të doni si e si që procesi të jetë lehtësues duke qenë lehtësues ai është gjithëpërfshirës dhe vinçerversa. Në këtë kuadër unë do të doja një përgjigje ne kushtet afatit 5 ditor që të llogarisim se ku jemi me këtë afat. Nga këto 16 mijë sa janë brenda afatit 5 ditor dhe a jeni ju në gjëndje që brenda datës së nesërme ti përgjigjeni atyre aplikantëve që i mbaron afati?

Znj. J. Josifi: Nga 16 mijë e disa kërkesa asnjërës nuk i ka kaluar afati i shqyrtimit as edhe njëjës.

Znj. H. Vukaj: Zonjë kjo është një llogari matematike e thjeshtë pra 11 plus 5. Unë të thashë dita e parë që presupozon që nesër i mbaron afati, ditës së dytë i mbaron pasnesër sa është ky numër? A i jeni përgjigjur të gjithë këtyre aplikantëve në kohë afatin 5 ditor?

Znj. J. Josifi: Do ti përgjigjemi të gjithëve në kohë.

Znj. H. Vukaj: Sa është ky numër?

Znj. J. Josifi: Numri i aplikantëve të ditës së parë?

Znj. H. Vukaj: Po, së ditë së parë që nesër i mbaron afati?

Znj. J. Josifi: 4 mijë aplikime kemi pasur.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Znj. H. Vukaj: Sa i jeni përgjigjur këtyre 4 mijë aplikimeve.

Znj. J. Josifi: Do të më duhet ta shohë këtë në sistem.

Znj. H. Vukaj: Pra, ju mendoni që 4 mijë aplikimeve nesër ju i përgjigjeni?

Znj. J. Josifi: Po.

Znj. H. Vukaj: Në rregull, nesëer do pyes dhe dua një informacion a vërtet u ruajt afati 5 ditor.

Znj. J. Josifi: Po patjetër.

Znj. I. Nano: Atëherë, të nderuar kolegë, pa dyshim që edhe unë bie dakord me kolegët që nëse vlerësohet nga ana e administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve vlerësohet që nevojitet ndonjë ndryshim gjithmonë në funksion të një procesi më të thjeshtë, më të shpejtë për zgjedhësit, për qytetarët shqiptarë që jetojnë jashtë vendit pa dyshim që është i mirëpritur për tu diskutuar në Komisionin Rregullator. Nga ana tjetër mendoj që të gjithë shqetësimet që u ngritën këtu po edhe të tjerat që ne mund ti marrim dhe personalisht edhe nëpërmjet mediave mendoj që mund tia drejtojmë me email apo edhe pyetje të tjera që kemi që kërkojnë kohë për të dhënë një përgjigje se padyshim është në tagrin e Komisionit Rregullator që të vlerësoj dhe rivlerësoj rregullat në kuptim të thjeshtësisë së tyre. Por çështja tjetër është çetije vetëm informacioni, sa kanë ardhur, sa kanë ikur, sa janë refuzuar? Që nuk besoj që duhet të jenë objekt i mbledhjeve tona. Ku informacionit mund ti marrim drejtëpërdrejtë në faqen e internetit ku dinamikat pasqyrohen minutë pas

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

minuti, apo drejtëpërdrejtë me administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
Nuk e di nëse keni diçka tjetër?

Znj. H. Vukaj: Nuk kam të njëjtin mendim zonja Nano. Kam edhe diçka tjetër për sa ju shtruat, unë mendoj se ky është vendi ku ne mund ta bëjmë diskursin publik, që na dëgjojnë të gjithë shqiptarët që kanë interes. Nuk e dinë se çfarë çohen me emaile që ndoshta nuk marrin kurrë përgjigje, e marrin pjesërisht, ose nuk na merret në konsideratë. Kjo nuk i intereson shqiptarëve, ndaj ky është vendi ku gjerat mund të bëhen publike dhe shqiptarët të dinë se si është ecuria. Ne mendoj që kemi absolutisht tagrin në funksion të atyre çfarë kemi miratuar dhe të atyre çfarë mund të ndryshojmë dhe të miratojmë në të ardhmen që ti shtrojmë pyetjet që na nevojiten për transparencën tonë dhe të shqiptarëve. Së dyti, unë kam një shqetësim me vendimin nr. 9 ku ne ndërhyëm në fund të muajit Dhjetor 2024 dhe e ndryshuam atë nën kushtin që po punohej nga Komisioneri dhe nga një grup pune këtu në KQZ apo nuk e di për ndryshimin e pjesës së parë të këtij vendimi. Një informacion të lutem keni ndërmarrë ju një paketë të cilën mund ta propozoni në vazhden e gjithë përshfaqes që po shohim që vendimi nr.9 as nuk merret më në konsideratë dhe ka një thyerje totale të asaj çfarë përbën veprimtari e ndaluar? Po baza është vendi nr. 9 i datës 24.12.2020.

Znj. P. Doçaj: Nuk kemi ndonjë propozim konkret për ditën e sotme, nëse do të kemi do ta propozojmë në vijimësi.

Znj. H. Vukaj: Për ditën e sotme u pa që nuk ishte në rend dite po vijimësi pasi mbaroi koha. Afati i katër muajve filloi kështu që juve gjatë mbledhjes paskeni mashtruar atëhere, që ky kusht varej nga punimi që po i bënit pjesës tjetër të aktit.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Pra, paskeni qenë në mashtrim dhe të pa interesuar për pjesën thelbësore të aktit i cili....

Znj. P. Doçaj: Nuk besoj se është termi i duhur për tu përdorur “mashtrimi” pasi na komporton dhe na sjellë gjëra të tjera pas, unë kam relatuar...

Znj. H. Vukaj: Çfarë na sjellë zonja prokurore, mashtrimi...

Znj. P. Doçaj: Unë kam relatuar...

Znj. H. Vukaj: Ai është mashtrim, gënjeshtër, mashtrim hapni fjalorin e gjuhës shqipe dhe identifikoni se çfarë do të thotë kjo.

Znj. I. Nano: Zonja Vukaj në mbledhjet tona është thënë që po punohet për këtë vendim dhe kur të jetë gati do ta sjellin.

Znj. H. Vukaj: Nuk erdhi, sepse afati mbaroi me datën 11...

Znj. P. Doçaj: Nuk mund të flas në mënyrë hipotetike nëse do të ndodhi, kur të ndodhi do tua propozojmë përpara jush.

Znj. H. Vukaj: Kur të mbaroj unë fjalën zonjë, do ta marrni ju fjalën...

Znj. P. Doçaj: Nuk jam prokurore dhe atë term, kam mbaruar një shkollë Juridik dhe e di shumë mirë.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Znj. H. Vukaj: Vlerësimin e bëre, në qoftë se e bëre në kushte shantazhi është gjë tjetër, në qoftë se do të më jepje mend është gjë tjetër pastaj...

Znj. P. Doçaj: Jo nuk ka shantazh fare. Jo në mënyrë absolute...

Znj. H. Vukaj: Fjalën merre pasi të mbaroj unë.

Znj. I. Nano: Atëherë, përgjigje pyetjes nëse ka...

Znj. P. Doçaj: Nuk kam mashtruar, se mu drejtuat mua dhe më thatë që ishit në kushtet e mashtrimit....

Znj. H. Vukaj: Jeni gjë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve?

Znj. P. Doçaj: Jo, kam folur në emrin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve....

Znj. H. Vukaj: Pikërisht pra, përkon që nuk është e vërtetë që ju jeni duke punuar ose është punuar. Nuk dimë ndonjë grup pune, pse nuk erdhën brenda afatit?

Znj. P. Doçaj: Kur kam relatuar dhe kam folur në emër të Komisionerit e autorizuar nga Komisioneri. Kam thënë çdo gjë që Komisioneri më ka autorizuar të them përpara jush.

Znj. H. Vukaj: Bukur! Pse nuk erdhën brenda afatit?

Znj. P. Doçaj: Cili afat? Nuk vendosëm afat, thamë që ishte në punim...

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Znj. H. Vukaj: Afati është katër muaj përpara datës së zgjedhjeve.

Znj. P. Doçaj: Kaq kam për të thënë.

Znj. H. Vukaj: Në fakt folët jashtë rradhe, aq sa fole... në fakt ti po thyen etikën zonjë. Duhet Komisioneri sot të marri masa ndaj teje për etikën tënde e cila lë për të dëshiruar në çdo mbledhje. Dakord, kështu! Keni marrë ju masa ose keni nisur ndonjë investigim tuajin apo hetim kryesisht në lidhje me çfarë po ndodh në lidhje me përfshirjen e administratës në shtete paralele.

Znj. I. Nano: Kishit një çështje jashtë rendit të ditës dhe janë trajtuar 3 deri tani. Njëra ishte për rregjistrimin, e shtetasve shqiptarë.

Znj. H. Vukaj: Nuk mund të kufizohemi zonjë për çështjet që ngremë...

Znj. I. Nano: Patjetër që mund të vendosim një rradhë diskutimi zonja Vukaj. Po pra ka tre çështje...

Znj. H. Vukaj: Kjo nuk është me kufinj as me kufizim.

Znj. I. Nano: Jo, unë dua të vendos rradhën e diskutimit kur kërkojë a ka çështje jashtë rendit të ditës.

Znj. H. Vukaj: Unë kaq kisha, dhe thashë a ka ndonjë iniciativë nga KQZ në kuadër të vendimit nr.9 për të gjithë çfarë po shohim në media.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Znj. I. Nano: Po zonja Çelmeta!

Znj. M. Çelmeta: Deri në këto momente që flasim nuk është paraqitur asnjë denoncim të administruar nga ana jonë.

Znj. I. Nano: Faleminderit!

Z. M. Çakaj: Më fal e paraqita unë një denoncim, po nuk është se mora ndonjë përgjigje. Shpresoj në vijim të marr një përgjigje konkrete. Në fakt nuk mora përgjigje për kërkesën time a ka autorizuar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ndonjë parti politike që ta ndihmojë në rregjistrimin e shtetasve shqiptarë me banim jashtë vendit? Nuk e di kush mund të më japi përgjigje, drejtoresha e votimit nga jashtë?

Znj. J. Josifi: Nuk besoj që është në kompetencat e KQZ-së të japi autorizime të tilla për askënd. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kompetencën të administrojë dhe menaxhojë në të gjithë komponentët e tij procesin e votimit nga jashtë dhe këtë ka bërë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve .

Z. M. Çakaj: Dakord, nuk keni dhënë asnjë autorizim.

Znj. J. Josifi: Si mund të japim?!

Z. M. Çakaj: Se nuk ta lejon Kodi Zgjedhor.

Znj. J. Josifi: Këtë thashë edhe unë.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Z. M. Çakaj: Është bërë publik një fakt të cilin nuk e di nëse e keni parë juve, po e kam parë unë, e kanë parë të gjithë shqiptarët. Është bërë publik në televizionet kombëtare shqiptare ku një eksponent i lartë i Partisë Socialiste, Niko Peleshi ka dalë në një zyrë jashtë vendit në të cilën asiston shtetasit shqiptarë me banim jashtë vendit për tu rregjistruar në PER. Madje ka bërë edhe lajmërim publik për ti ndihmuar, për ti asistuar. Ndërkohë që në vendimin tonë ne kemi përcaktuar që procesi i rregjistrimit është individual. Në funksion të kësaj, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të bënte një edukim zgjedhor, duhet të bënte një informim sa më të gjerë sepse është tagri i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kuvendi ja ka ngarkuar KQZ-së gjithë këtë proces. Në rastin konkret a ndodhemi përballë një shkelje? Shkelje është. Është fakt i njohur publik, unë e denoncova, është fakt i njohur publik e kanë dhënë televizionet.

Znj. I. Nano: Në mbledhjet e rregullatorit vendoset për denoncimet apo në mbledhjet e organeve të tjera. Në qoftë se ky është denoncim publik ta përcjellim në organet e tjera.

Z. M. Çakaj: Po pse çfarë problemi ka ta denoncojmë? Çfarë do qepim gojën këtu ne, ai është fakt i njohur publik.

Znj. I. Nano: Jo, nuk më kuptove, e denoncove.

Znj. P. Doçaj: Kemi një portal të përcaktuar, portali i denoncimeve. Bëhet sipas rregullave të përcaktuara...

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Z. M. Çakaj: Pse nuk vlen kjo publik...

Znj. I. Nano: Nuk mund të shqyrtohet këtu edhe nëse është një denoncim.

Z. M. Çakaj: Në vendimin nr.9 e ka tagrin KQZ ta inicioj edhe kryesisht. Unë po jap indicie, ka tagrin ta iniciojë edhe kryesisht atë.

Znj. J. Josifi: Atëhere, faleminderit! Unë vetë nuk e kam parë, nuk e kam pasur mundësinë të ndjek aktualitetin.

Z. M. Çakaj: Patjetër keni qenë e zënë me procesin...

Znj. J. Josifi: Ne jemi angazhuar me që për edukimin e zgjedhësve dhe mendoj jo vetëm ne por edhe vizibiliteti që i ka dhënë media edhe vetë partitë politike me thirrje për mbështetësit e tyre. Praktikisht votimi nga jashtë është tema e ditës. Ndërkohë për rastin specifik që ju sapo dhatë indicie...

Z. M. Çakaj: Që të jemi të qartë për diçka, thirrjet e partive politike, kujt do aktori politik, i cili më pas do të marrë cilësinë e subjektit zgjedhor është një gjë dhe është legjitime shumë normale. Procesi i ndërmjetësimit, procesi i ndihmës, procesi i aksesit në zyrat e krijuara posaçërisht për rregjistrimin në gjykimin dhe këndvështrimin tim është totalisht e gabuar, është e paligjshme, sepse është e paligjshme në raport me vendimmarrjen tonë. Nga ana tjetër mua më lind dyshimi a është bërë mjaftueshëm informimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe edukimi zgjedhor për zgjedhësit? Është i mjaftueshëm apo kemi të bëjmë sepse me këtë përgjigje dua të arrij tek paligjshmëria.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Znj. I. Nano: Këtë edhe sikur, në këndvështrimin e secilit prej nesh, një veprim të jetë i paligjshëm. Në këndvështrimin ligjor as njëri nga ne këtu dhe të gjithë ne së bashku nuk shqyrtojmë denoncime dhe nuk marrim vendime mbi denoncimet. Nuk ka asnjë denoncim... E kanë apo nuk e kanë këtë fakt ato nuk e dinë, ja ia u vuri në dispozicion kolegu. Nuk ka pra ua u tha, mund të pyetet 10 herë dhe të përsëritet 10 herë e njëjta gjë. A ka denoncim? A keni marrë ndonjë gjë kryesisht? Mundet ta njihni mund të mos e njihni këtë fakt fare.

Znj. J. Josifi: Nuk është administruar asnjë denoncim nga asnjë zgjedhës apo asnjë palë. Ne jemi angazhuar prej kohësh në edukimin zgjedhor për votimin nga jashtë dhe jemi çdo ditë duke publikuar sqarime për zgjedhësit, manuale për zgjedhësit, video ilustruese për zgjedhësit, duke bërë deklarata publike. Kjo çështje, çështja e ngritur nga ju dhe rasti konkret i zotit Peleshi nuk është një çështje e cila ka nevojë ose për të cilën mund të japim një opinion apo një mendim nëse do të duhet të ketë një vendimmarrje të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për këtë rast apo për raste të tilla, kjo është në tagrin e tij. Aktualisht nuk kemi nisur asnjë lloj procesi verifikues apo të çfarëdo lloji, kjo është përgjigja.

Z. M. Çakaj: Po faleminderit jam i qartë, domethënë deri tani ju nuk e shikoni përsa kohë nuk ka nisur një hetim kryesisht nuk e shikoni si problematike këtë gjë.

Znj. I. Nano: Zonja Josifi ju e menaxhoni portalin e denoncimeve?

Znj. J. Josifi: Jo.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 15.01.2025*

Znj. I. Nano: Atëhere, përgjigjesh për gjëra që nuk të takojnë ty. Kush e menaxhon nga ju këtu? Ka ndonjë drejtori përkatëse apo do flasim me Sekretarin e Përgjithshëm?

Znj. P. Doçaj: Unë sapo e thashë, e tha edhe Sekretari i Përgjithshëm nuk kemi të administruar asnjë denoncim. Kaq. As kryesisht nuk kemi ndërrmarë asnjë veprim.

Znj. I. Nano: Faleminderit! Për dy partitë politike që po ngrenë dorën, jeni për çështje jashtë rendit të ditës? Duhet ta kishit kërkuar në fillim. Nuk patëm, jo folëm për individë të caktuar, nuk e di zoti Nuri mund të kishte replikë me kë pastaj. Gjithësesi, çështjet jashtë rendit të ditës, unë mendoj që u adresuan, një pjesë morën përgjigje. Një pjesë mbetën për përgjigje qoftë për informacione që mund të na i përcillni me email, qoftë për informacione që kuptohen do të përcillen publikisht nga Komisioneri por edhe në mbledhjen tonë të ardhshme nëse pret koha. Në çdo rast meqenëse nesër mbyllet 5 ditëshi i parë i shqyrtimit të kërkesave për kërkesat që kanë ardhur ditën e parë. Unë u uroj që të ketë një njoftim publik por nëse jo edhe në email tona në përgjigje të kërkesës së koleges Vukaj. Faleminderit të gjithëve mbledhjen e deklaroi të mbyllur.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*

